



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No
01	05-7489
Nr. i faqeve Br. stranice No. pages	Data: Datum: Date:
- 23 -	21, 11, 20 23
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

**Nr.191/XI/2023**

**Datë:20.11.2023**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës , nxjerrë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet Plani i veprimit për paramedik në sistemin e kujdesit shëndetësor të kosovës, forcën e sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera që ofrojnë shërbimin emergjent 2023-2025.
- II. Shtojcë e vendimit është Plani i veprimit për plani i veprimit për paramedik në sistemin e kujdesit shëndetësor të kosovës, forcën e sigurisë së kosovës dhe institucionet tjera që ofrojnë shërbimin emergjent 2023-2025
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

**Dr. Arben Vitia**

**Ministër i Shëndetësisë**

**Vendimi i dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Departamenti ZhSSH;
- Arkivot të MSh-së;





**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria-Vlada-Government*

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

**PLANI I VEPRIMIT PËR PARAMEDIK NË SISTEMIN E KUJDESIT  
SHËNDETËSOR TË KOSOVËS, FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS DHE  
INSTITUCIONET TJERA QË OFROJNË SHËRBIMIN EMERGJENT 2023-2025**

*Prishtinë*

## **PËRMBATJA**

- 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**
- 2. HYRJE**
- 3. METODOLOGJIA**
- 4. SFONDI**
- 5. OBJEKTIVAT**
- 6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT**
- 7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT NACIONAL**
- 8. SHTOJCA 1 - PLANI I VEPRIMIT**

## SHKURTESAT

AMF	Ambulanta e mjekësisë familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KPSh	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KDSh	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KTSh	Kujdesi Tretësor Shëndetësor
MSh	Ministria e Shëndetësisë
FSK/ MB	Forca e Sigurisë së Kosovës/ Ministria e Mbrojtjes
NALT	Ekipi Këshilltar Ndërlidhës i NATOS
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKU	Qendra Klinike Universitare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
UA	Udhëzimi Administrativ

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shërbimi mjekësor i Paramedikeve është një nga shërbimet kyçe emergjente/paraspitalore për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet serioze të pa pritura, aksidentet në komunikacion, fatkeqësitë natyrore si dhe incidentet e ndryshme të shkaktuara nga faktori njeri që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e qytetarëve të vendit tonë, të cilat përmes shërbimit mjekësor të paramedikëve, janë masë parandaluese për zvoglimin e viktimave në nivel vendi. Përmes ofrimit të shërbimit mjekësor të paramedikeve për popullatën, synohet të zvoglohet shkalla e vdekshmerisë në aksidentet e komunikacionit, respektivisht arritja e mbulueshmërisë së ofrimit të shërbimit mjekësor emergjent.

Plani i veprimit për shërbimin mjekësor emergjent të paramedikeve 2023-2025 ofron një përmbledhje të veprimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë nga institucionet shëndetësore në Kosovë, në bashkëpunim me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë, për të mbrojtur shëndetin publik të popullatës përmes shërbimit mjekësor emergjent të paramedikëve si një komponent kyç i kujdesit emergjent shëndetësor dhe si një e drejtë e padiskutueshme e njeriut.

Plani synon të arrij mbulueshmërinë e ofrimit të rregullt të shërbimit emergjent në vend, duke marrë për bazë faktin se gjatë viteve të fundit, është shënuar ngritje e shkallës së vdekshmerisë së qytetarëve për shkak të aksidenteve të shumta të komunikacionit dhe rritjes së rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Sipas raporteve të MPB-së dhe PK-së, shkalla e vdekshmerisë si pasojë e aksidenteve në komunikacion gjatë viteve të fundit ka pasur rritje të viktimave të të gjitha moshave dhe gjinive. Gjithashtu, përmes ofrimit të këtij shërbimi mjekësor synohet të rritet niveli i ofrimit të shërbimeve emergjente dhe zvoglimi i vdekshmerisë në vend. Ngritja e këtij shërbimi mjekësor do të arrihet përmes certifikimit të infermierëve për shërbimin paramedikë si dhe krijimin e profilit të ri profesional në vendin tonë.

Një prej masave të arritjes së synimit të mbulueshmërisë të ofrimit të rregullt të shërbimit emergjent është ngritja e njohurive së infermierëve/kompetences për këtë profil shëndetësor në vendin tonë. Për t'u ngritur kompetenca e infermierëve hapi i parë propozohet të jetë hartimi i një plan programi me mbështetjen dhe ndihmën e stafit vendor duke përfshirë edhe Departamentin e Infermierisë me synim që në të ardhmen të sigurohet vazhdimësia e edukimit dhe trajnimit të

brezave të ardhshëm, pasi në Kosovë nuk është i mbulur ofirimi i shërbimeve emergjente siç u theksua më lart.

Realizimi i pjesës teorike dhe praktike propozohet të realizohen me kycjen e stafit ndërkombëtar dhe vendor, përfshirë edhe stafit i cili do të aftësohet nëpërmjet edukimit dhe trajnimeve kurse realizimi i ndonjë vizite studimore të vendeve me shërbim dhe kujdesje të avancuar të Paramedikëve do të ndikonte në avancimin e njohurive dhe praktikave të profesionistëve të Kosovës për këtë lëmi. Në këtë plan të veprimit parashihet krijimi i profilit paramedik në studimet bazike në Fakultetin e Mjekësisë.

Plani i Veprimit për Paramedik 2023-2025 përmban risi sa i përket përfshirjes së ofrimit të shërbimit mjekësor të paramedikëve në institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës përfshirë: Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), Agjencinë për Menagjimin e Emergjencave (AME), Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Policinë e Kosovës (PK).

Qëllimi kryesor i këtij plani është inkurajimi dhe avancimi i mëtejshëm i shërbimit emergjent, si masë parandaluese ndaj nivelit të lartë të vdekjeve nga aksidentet e ndryshme në komunikacion, vende të punës dhe fatkeqësive natyrore në nivel vendi.

Kosova ka shënuar shkallën më të lartë të vdekshmerisë në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe është vendi me shkallën më të lartë të largimit/migrimit të personelit profesional shëndetësor me 51% kundrejt mesatares në këtë rajon që është 43.5%.

Shërbimi mjekësor i paramedikëve është një ndërhyrje tjetër e paraparë në këtë plan, për t'u ndërmarrë si përgjigje ndaj shkallës së lartë të vdekshmerisë dhe në mbështetje të masave përforcuese të shërbimit mjekësor emergjent.

Plani i veprimit për shërbimin mjekësor të paramedikëve parasheh fuqizimin e kapaciteteve aktuale të shërbimit emergjent, krijimin dhe formësimin e shërbimit të paramedikëve për të qenë me afër qytetarëve, me qëllim të mbulueshmërisë sa më të mirë në të gjithë vendin.

Plani parasheh poshtu funksionalizimin e paramedikëve përmes mekanizmave të Ministrisë së Shëndetësisë, Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK), Ministrisë së Arsimit dhe Fakultetit të Mjekësisë si dhe institucioneve tjera relevante në këtë proces.

Arritja e objektivës kryesore dhe atyre specifike të këtij Plani do të përfshihen me planin e trajnimit dhe shkollimin duke u mbështetur në nivelin e përgatitjes profesionale në nivel vendi dhe është i harmonizuar me vendet mike duke u bazuar në përvojën dhe rekomandimet e eksperteve të përfaqësuesve të ekspertëve Amerikan, Gjerman, shërbimi mjekësor i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministris së Arsimit dhe AME.

Plani i Veprimit për shërbimin mjekësor të paramedikëve ka rëndësi të veçantë, sepse përmes këtij shërbimi, që është një nga investimet më të mira shëndetësore, do të kontribuoj në rritjen e mbulushmërisë me shërbime urgjente të popullatës dhe rrjedhimisht edhe në zvoglimin e vdekshmërisë nga fatkeqësitë natyrore, aksidente të shumta në trafik të cilat mund të mbështeten përmes shërbimit të paramedikëve.

## HYRJA

Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive të reja të Shërbimit Mjekësor Emergjent në Republikën e Kosovës synon të zhvilloi dy profesione të reja, atë Paramedikeve dhe Medikeve, për të mbështetur shërbimin emergjent mjekësor.

Kjo do të jetë një nga arritjet e synuara të MSh dhe Institucionet tjera për menagjimin e emergjencave.

Mjekësia emergjente jep një kontribut kritik në kujdesin shëndetësor në nivelin primar, i cili është edhe një aset kombëtar që ofron kujdes/shërbim emergjent mjekësor dhe përgjigjesi e gatishmërisë operacionale ndaj fatkeqësive dhe sfidave në rritje në vend. Në këtë kontekst, institucionet e ndryshme që involvohen në menaxhimin e emergjencave si Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME), Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Policia e Kosovës (PK) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, përfitojnë nga profesionet e reja dhe ofrojnë një reagim të plotë efikas dhe emergjent bazuar në përgatitjen, përvojën dhe kualifikimet e tyre në mjekësinë emergjente.

Sipas TOPP (Tabela Organizative për personel dhe Pajisje) në FSK, pozitat e paramedikeve do të plotësohen me staf në nivele të ndryshme të ofrimit të shërbimit mjekësor me qëllim të rritjes së kapaciteteve të ofrimit të shërbimit mjekësor emergjent në FSK.

Paramedikët janë personel i specializuar i kujdesit urgjent paraspitalor, të cilët janë të arsimuar dhe trajnuar në mënyrë specifike për menagjimin e emergjencave mjekësore. Paramediku i urgjencës është një nga profesionet mjekësore në sistemin e kujdesit shëndetësor me kualifikimin më të lartë mjekësor në shërbimin emergjent, pas mjekëve/specialistëve të emergjencës. Pasi që nuk ka ekspertizë për këtë profesion në Republikën e Kosovës, ky dokument strategjik është një tregues i hapave të ardhshëm për të siguruar shkollime/trajnime të qëndrueshme të bazuara në ligj dhe aftësi profesionale. Krijimi i profesioneve të reja në shërbimin e urgjencës mjekësore mundëson tejkalimin e sfides së vendit me mungesën e mjekëve dhe infermierëve, e veqanërisht mungesës së stafit mjekësor në vend.

Shërbimi i paramedikëve ofron mundësi të mirë për ofrimin e shërbimeve mjekësore të domosdoshme gjatë realizimit të aktiviteteve dhe intervenimeve të ndryshme në situata emergjente.

Për zhvillimin e sistemit të kujdesit emergjent shëndetësor kemi marrë rekomandime nga këshilltaret e NATO ADVISORY LIASION TEAM (NALT-it) dhe nga vendet partnere të cilët janë duke dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e Paramedikeve.



Përmes ofrimit të shërbimit mjekësor të paramedikeve në vend, synohet zvoglimi i shkallës të vdekshmërisë nga aksidentet e ndryshme, respektivisht arritja e mbulueshmërisë së ofrimit të shërbimit mjekësor emergjent, në vend duke marrë për bazë faktin se gjatë viteve të fundit, është shënuar ngritje e shkallës së vdekshmërisë së qytetareve për shkak të aksidenteve të shumta të komunikacionit, aksidenteve në vendet e punës dhe rritja e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Duke marrë për bazë praktikat e vendeve partnere të cilat e kanë të zhvilluar këtë shërbim dhe rekomandimet e tyre, përmes zhvillimit dhe ofrimit të këtij shërbimi mjekësor synojmë të jemi sa më afër qytetarëve me ofrimin e shërbimit mjekësor emergjent si dhe të kemi ulje të shkallës së vdekshmërisë nga: aksidentet në komunikacion, aksidentet në punë dhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore.

Shërbimi mjekësor i paramedikëve është një ndërhyrje e paraparë në këtë plan të veprimit, për t'u ndërmarrë si përgjigje ndaj shkallës së lartë të vdekshmërisë dhe në mbështetje të masave përforcuese të shërbimit mjekësor emergjent. Krijimi i këtij shërbimi është domosdoshmëri e kohës duke pasur parasysh që Kosova ka shënuar shkallën më të lartë të vdekshmërisë në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe është vendi me shkallën më të lartë të largimit/migrimit të personelit profesional shëndetësor me 51% kundrejt mesatares në këtë rajon që është 43.5%.

Në kontekstin ligjor, profesioni i Paramedikeve është përmendur në Ligjin "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore". Ligjet e mëposhtme përbëjnë bazën ligjore për këtë plan veprimi dhe duhet të përdoren si referencë gjatë zbatimit të këtij profesioni:

1. LIGJI Nr. 03/L-060 PËR KUALIFIKIMET KOMBËTARE
2. LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI
3. LIGJI Nr. 04/L-138 PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL
4. LIGJI Nr. 04/L-143 PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PËR TË RRRITUR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
5. LIGJI Nr. 04/L-150 PËR ODAT E PROFESIONISTËVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
6. LIGJI Nr. 05/L-024 PËR SHËRBIMIN MJEKËSOR EMERGJENT

### 3. METODOLOGJIA

Plani i veprimit për paramedik 2023-2025 është hartuar bazuar në metodologjinë e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ (UA) (QRK) 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

Plani është hartuar nga grupi punues i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë (MSh), dhe anëtarësi të profesionistëve tjerë të cilët posedojnë njohuri dhe shkathtësi për fushën e caktuar si dhe ekspertizë për hartim të dokumenteve strategjike, përfshirë përfaqësues nga FSK / MB dhe NALT.

Për përgatitjen e planit janë shqyrtuar të dhëna të bazuara në dëshmi nga studimet, raportet dhe dokumentet e tjera të siguruara nga MSh, ASK, hulumtime dhe dokumente tjera relevante të ndërlidhura me këtë fushë. Janë shqyrtuar dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të përfitimit të njohurive dhe përvojave nga zhvillimet e këtyre shërbimeve në sistemin shëndetësor, me qëllim të krahasimit të kësaj fushe me vendet tjera, përvojat ndërkombëtare me fokus të veçantë në përvojat e vendeve që kanë ngjashmëri relevante për temën e dokumentit strategjik si dhe standardet ndërkombëtare ekzistuese.

Grupi punues ka identifikuar mënyrat për të adresuar këto sfida me qëllim të realizimit të aktiviteteve dhe arritjes së objektivave dhe rezultateve të përcaktuara për periudhën kohore trevjeçare.

### 4. SFONDI

#### 4.1. Karakteristikat demografike dhe statistikat vitale të popullatës


Republika e Kosovës ka sipërfaqe prej 10,908 km<sup>2</sup>. Kosova ka gjithsej 38 komuna me 1.469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit. Sipas vlerësimit të Agjencisë Kosovare të Statistikave (ASK) për vitin 2019, numri i përgjithshëm i popullsisë në Kosovë është 1,782,115<sup>1</sup>. Kosova karakterizohet me strukturë të re të popullsisë, ku mosha mesatare është 30.2 vjet. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të

---

<sup>1</sup> Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Statistikave, 2020

popullsisë, rreth 61% e popullsisë jeton në zonat rurale, kurse 38% në zonat urbane.

Piramida e popullsisë sipas Vlerësimit të Popullsisë për vitin 2019



Graf. 1. Piramida e popullsisë sipas Vlerësimit të popullsisë për vitin 2019

#### 4.2. Gjendja shëndetësore e popullatës në Kosovë<sup>1</sup>

Në vitin 2020 nataliteti në Kosovë ishte 11.9 ‰, mortaliteti ishte 8.0 ‰ dhe shtimi natyror i popullsisë ishte 3.9 ‰<sup>2</sup>. Të dhënat e fundit tregojnë se numri i përgjithshëm i vdekjeve në vitin 2019, në Kosovë është 9,430 ndërsa koeficienti i mortalitetit është 5.3 të vdekur në 1000 banorë<sup>3</sup>.

#### Aksidentet në komunikacion

Infrastruktura rrugore, pakujdesia si drejtues të automjeteve por shpesh herë edhe mospërshtatja me rregullat e trafikut kanë ndikuar që nga viti në vit në Kosovë të ketë numër të lartë të aksidenteve në komunikacion. Aksidente me dëme

<sup>2</sup> ASK Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve 2020

<sup>3</sup> ASK, Statistikat e vdekjeve, 2019

materiale, me të lënduar e deri tek ata që morën jetë janë raportuar vazhdimisht gjatë vitit 2022.

Madje nga viti në vit në Kosovë janë shqetësuese shifrat e aksidenteve që ndodhën në rrugët e vendit. Të dhënat nga Policia e Kosovës, gjatë vitit 2022, deri në muajin nëntor 2022 janë regjistruar 18 mijë e 886 aksidente trafiku. Si shkak i këtyre aksidenteve shumë qytetarë mbetën të lënduar. Numri i aksidenteve me të lënduar brenda periudhës janar-nëntor 2022 ishte 7 045 aksidente. Nga këto aksidente u lënduan gjithsej 13 mijë e 369 persona.

Përpos kësaj, aksidentet e rënda në trafik qenë shkaktar edhe të humbjes së jetës së shumë qytetarëve.

Nga Policia është bërë e ditur se gjatë periudhës janar-nëntor 2022 jetën humbën 98 persona nga gjithsej 87 aksidente me fatalitet.

Në kuadër të mbi 18 mijë aksidenteve trafiku që ndodhën brenda 2022, ishin edhe 11 mijë e 754 aksidente me dëme materiale.

Të ngjashme ishin shifrat edhe për aksidentet e ndodhura në vitin 2021. Në periudhën janar-nëntor 2021 në Kosovë janë raportuar gjithsej 19 mijë e 212 aksidente. Si shkak i këtyre aksidenteve patën humbur jetën 102 persona nga gjithsej 91 aksidente fatale. Në këtë periudhë vjetore nga Policia e Kosovës janë raportuar gjithsej 6 mijë e 918 aksidente me të lënduar, ku të lënduar mbetën 13 mijë e 290 qytetarë. Nga mbi 19 mijë aksidente trafiku gjithsej, në total ishin gjithsej 12 mijë e 203 aksidente me dëme materiale.

Nga institucionet e sigurisë në vend vazhdimisht është bërë thirrje për kujdes të shtuar në trafik, në mënyrë që të anashkalohen aksidentet në numër të lartë të cilat në të shumë shpesh përfundojnë me fatalitet.

### **Situata aktuale me aksidente, lëndime në nivel global dhe regjion**

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë jo vetëm për Republikën e Kosovës, por edhe për shumë shtete të Evropës dhe të Botës.

Sipas raportit “Fatalities for 2020 – Annual Statistics for Western Balkans” në të cilin janë analizuar statistikat e aksidenteve me vendet e Ballkanit Perëndimor i publikuar me datë 20.04.2021, për vdekjet në aksidentet e trafikut rrugor për vitin 2020 dhe krahasimin 2010-2020 për 1 milion banorë, vërehet se vendi ynë, krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, ka më së paku vdekje për 1 milion banorë.


Meqë aksidentet në trafikun rrugor paraqesin një problem të natyrës multi-disiplinare atëherë edhe përballja me këtë problem kërkon angazhimin e të gjithëve, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të kemi sukses në uljen e mëtutjeshme të numrit të aksidenteve, e në veçanti të atyre me fatalitet.

Policia e Kosovës do të vazhdoj të angazhohet edhe më tutje në ngritjen e nivelit të sigurisë në trafik dhe parandalimit të aksidenteve në përgjithësi.

Në vijim janë grafikonet dhe linqet e raporti të publikuar: Fatalities for 2020 – Annual Statistics for Western Balkans; Fatalities for 2020 – Annual Statistics for Western Balkans;

## Overview - Western Balkans Developments

**Figure 1:** Fatalities per million inhabitants in the Western Balkans 2020



Note: The official data for Bosnia and Herzegovina are not yet available

<https://www.transport-community.org/wp-content/uploads/2021/04/Annual-Statistics-2020.pdf>

[https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_1767?utm\\_source=ETSC&utm\\_campaign=71073a749a-20200709-](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_1767?utm_source=ETSC&utm_campaign=71073a749a-20200709-)

[PIN\\_corona\\_briefing\\_COPY\\_01&utm\\_medium=email&utm\\_term=0\\_3a7b55edbf-71073a749a-136654993](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_1767?utm_source=ETSC&utm_campaign=71073a749a-20200709-PIN_corona_briefing_COPY_01&utm_medium=email&utm_term=0_3a7b55edbf-71073a749a-136654993)

<https://etsc.eu/etsc-statement-on-the-2020-eu-road-death-figures/>

### **4.3. Rrjeti i institucioneve dhe mbulueshmëria me shërbime emergjente**

Shërbimet shëndetësore në Kosovë ofrohen nëpërmjet rrjetit të institucioneve shëndetësore të organizuara në tri nivele: parësor (KPSH), dytësor (KDSH) dhe tretësor (KTSh). Rrjeti publik i KPSH përbëhet nga gjithsej 458 institucione, nga të cilat secila komunë e Kosovës ka Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, me njësi të saj përbërëse: Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF). Në KPSH janë të angazhuar 552 mjekë familjarë dhe 1664 infermierë familjarë. Shërbimet në kujdesin parësor shëndetësor ofrohen përmes konceptit të mjekësisë familjare i cili konsiston në ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi për individin dhe familjen, në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur. Për të arritur standardin sipas UA 04/2022 për KPSH për ekip të mjekësisë (një mjek familjar me dy infermiere për 2000 banorë) nevojiten edhe 353 mjekë familjarë dhe 164 infermiere familjare.

Stafi i angazhuar në shërbime emergjente në KPSH është i përbërë prej 246 mjekëve, 563 infermiereve dhe 188 staf tjetër.

Shërbimet shëndetësore emergjente në kujdesin dytësor dhe tretësor ofrohen nëpërmjet 7 spitaleve të përgjithëshme dhe QKU. Në spitalet e përgjithëshme dhe QKU stafi i angazhuar në këtë shërbim është:

Klinika Emergjente- QKUK- 66 infermier  
Spitali i Ferizajt- 24 infermier  
Spitali i Gjakovës-18 infermier  
Spitali i Mitrovices – 20 infermier  
Spitali Vushtrrisë-12 infermier  
Spitali i Pejës- 24 infermier  
Spitali i Prizrenit- 24 infermier  
Spitali i Gjilanit- 28 infermier

Po ashtu, shërbimi shëndetësor emergjent realizohet edhe në 4 spitale të përgjithëshme private dhe stafi i angazhuar në këtë shërbim është 20 infermier.

Gjithashtu në FSK aktualisht janë në shërbim rreth 70 pjestarë të FSK, ndërsa duke u bazuar në planin e zhvillimit të FSK numri i pjestarëve që kanë nevojë për shkollim/trajnim për paramedik duhet të jetë deri 25 pjestarë.

Ndërsa, AME sipas informatave të tyre aktualisht ka nevojë për shkollimin/trajnimin e minimum 140 pjestarëve dhe për ti përmbushur të gjitha nevojat e tyre në të ardhmen ky numër duhet te jetë rreth 250 pjestarë.

Shërbime shëndetësore në Policinë e Kosovës ofrohet nga:

Drejtoria e Përgjithshme të PK-së - 2 infermier

Drejtorinë Rajonale te Prishtinës - 1 infermier

Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës - 1 infermier

Drejtorinë Rajonale të Gjilanit - 1infermier

Drejtorinë Rajonale të Pejës - 1Infermier

Drejtorinë Rajonale të Gjakovës - 1 infermier

Drejtorinë Rajonale të Ferizajit 1 infermier -E pa aftë për punë -Lëndim në detyrë.

Në bazë të informatave nga Policia e Kosovës numri i infermierëve që kanë nevojë për shkollim/trajnim për paramedicë janë 8- tetë Infermier.

## **5. OBJEKTIVAT**

Plani i veprimit për paramedik në sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës 2023-2025 dhe institucionet tjera që ofrojnë shërbimin emergjent synohet të zbatohet përmes aktiviteteve në kuadër të **Objektivës strategjike I: Krijimi i shërbimit paramedik në nivel vendi**

Kjo objektivë strategjike synohet të zbatohet përmes aktiviteteve në kuadër të tri objektivave specifike :

**Objektiva specifike 1. Ngritja e kapaciteteve profesionale për shërbimin paramedik**

**Objektiva specifike 2. Krijimi i profilit paramedik ne studimet bazike**

## 6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Realizimi i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të veprimit për stafin mjekësor dhe paramedik në sistemin shëndetësor 2023-2025, do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të veprimit, sipas të dhënave zyrtare, të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSh-në.

Bazuar në indikatorët kyç të definuar në Plan të veprimit, monitoron indikatorët sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe raporton në MSh duke siguruar që institucionet dhe departamentet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Ky proces do të ndikoj në ndryshimin dhe plotësimin vjetor të Planit të Veprimit. Parim udhëheqës gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit është gjithëpërfshirja, ku në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë akterët dhe institucionet hisedare në këtë fushë përmes shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale, procedurave të brendshme dhe mekanizmave tjerë administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Në këtë proces, theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera të përfshira. Ky dokument përfshin një numër të indikatorëve në nivele të ndryshme të zbatimit për periudhën kohore të përcaktuar në dokument, duke shfrytëzuar burime të informatave, raportime në periudha të rregullta përmes strukturave të përcaktuara të procesit të monitorimit. Korniza e monitorimit ka për qëllim përcjelljen e progresit dhe rishikimet eventuale bazuar në progresin e shënuar.

Raportimi do të jetë periodik, me kohë i zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimet për ndryshime gjë që do të mundësojë adresimin në kohën e duhur që ka për qëllim orientimin e politikave për shërbimet mjekësore emergjente. Rezultatet e pritura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojnë edhe ofrimin e informatave kthyesë efektive dhe me kohë për të gjitha grupet e interesit, ofrimin e raporteve të performancës së tyre, raportet fillestare ku janë të përcaktuara vlerat bazë të treguesve krahasuar me vlerat e pritshme dhe të dëshirueshme, raportet periodike të progresit si dhe raportet vjetore të performancës. Vlerësimi përfundimtar i dokumentit do të ofroj të dhëna të



bazuara në dëshmi të cilat do të shfrytëzohen si bazë për përcaktimin e kahjeve strategjike në periudhat e ardhshme si dhe hartimin e dokumenteve tjera në vazhdimësi. Raporti i monitorimit të progresit, zbatimit dhe arritjeve të planit të veprimit do t'i prezantohet të gjitha institucioneve hisedarë si dhe instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

## **7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANI**

**PLANI I VEPRIMIT PËR STAFIN MJEKËSOR DHE PARAMEDIK NË SISTEMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR TË KOSOVËS DHE NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS DHE INSTITUCIONET TJERA QË OFROJNË SHËRBIMIN EMERGJENT 2023-2025**

<b>Objektiva strategjike</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Caku 2023</b>	<b>Caku 2025</b>
<b>Krijimi i shërbimit paramedik në nivel vendi</b>				
<b>Objektiva specifike 1</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Caku 2023</b>	<b>Caku 2025</b>
<b>Ngritja e kapaciteteve profesionale për shërbimin paramedik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i infermierëve në institucionet shëndetësore të trajnuar për ofrimin e shërbimit paramedik</li> </ul>	0		799
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i infermierëve në institucionet tjera të trajnuar për ofrimin e shërbimit paramedik në FSK, PK dhe AME që do të trajnohen</li> </ul>	0		173

Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Instucioni mbështetës	Produkti
1.1 Hartimi i plan programit të trajnimit për paramedik	2023	5,450.00 €	BK	MSh	OIK FSK NALT	Planprogrami hartuar dhe akredituar nga OIK
1.2 Përvoja nga shtetet tjera për hartimin e plan programit për paramedik	2023	7.000.00 €		MSh		Vizita studimore e 5-7 pjesemarres
1.3 Hartimi i procedurave standarde të operimit (PSO) në kuadër të procesit të shërbimit mjekësor të paramedikëve.	2023 - 2025	5,450.00 €	BK	MSh FSK PK		PSO të hartuara
1.4 Trajnimet për ToT	2024	47.000.00 €	BK	MSh	QKUK FSK PK AME	50 ToT

1.5 Trajnimet për ofrimin e Shërbimeve Paramedik	2024	17.000.00 €				799 infermier të trajnuar në KPSH dhe KDSH dhe KTSH 25 infermier të trajnuar në FSK 8 infermier të trajnuar në PK 140 infermier të trajnuar AME
1.6 Trajnimet për ofrimin e Shërbimeve Paramedik	2025	20.000.00				
1.7. Sigurimi i pajisjeve për trajnimin për paramedik	2024	30.000.00 €		MSh		Pajisjet e siguruara

Objektiva specifike 2		Indikator (-ët) për matjen e arritjes së objektivit		Baza	Caku 2023	Caku 2025
Krijimi i profilit paramedik ne studimet bazike		Numri i studentëve në studimin e paramedikëve		MSh- Departamenti i Infermierisë	///	120
		Numri i profesionistëve të aftësuar për trajtimin e paramedikëve		Fakultetet e mjekësisë	///	50
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Instucioni mbështetës	Produkti
2.1. Inicimi i marrëveshjes nga MSh me Dep. Infermierisë /Fakulteti i Mjekesise dhe MASHT	2023		Buxheti i Kosovës	MSh	MSh Fakulteti i Mjekësisë MASHT FSK MPB Organizatrat donatore	Marrveshja e nënshkruar

					ndërkombëtare	
2.2. Formimi i Grupit akademik profesional për krijimin e syllabusit	2023-2024					Syllabusi i krijuar Kurrikilat e hartuara dhe aprovuara
2.3. Hapja e Departamentit të Studimeve Bachelor - Drejtimi Paramedik	2024		Buxheti i Kosovës Organizatave ndërkombëtare	1.Fakulteti i Mjekësisë	1. MSh 2. MASHT	Departamenti Paramedik Funksionon

2.4. Diplomimi i gjeneratës së para në Departamentin Paramedik	2026			1.Fakulteti i Mjekësisë	1. MSh 2. Organizatat donatore	30 student të diplomuar në barchelor
--	------	--	--	-------------------------	-----------------------------------	--------------------------------------